

19 Korrik 2024

**Lënda: Përgjigje shkresës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar**

**Drejtuar:** Kryetarit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”

**I nderuar Kryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar, Z. Fatmir Xhafaj,**

Që nga shkurti i vitit 2023, Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) Shqipëri po zbaton në bashkëpunim të ngushtë me Kuvendin e Shqipërisë projektin “Rritja e Llogaridhënies së Qeverisë përmes një Parlamenti më Reagues”, me mbështetjen financiare të Ambasadës Britanike në Tiranë. Projekti ka si qëllim të sjellë praktikë më të mira ndërkombëtare për forcimin e rolit mbikëqyrës të Kuvendit. Mbështetja është fokusuar në dy fusha kryesore: Kontrollin Post-Legjislativ dhe Vlerësimin Preventiv të Korrupsionit në proceset ligjberëse.

WFD në mbështetje dhe bashkëpunim të ngushtë me Kuvendin e Shqipërisë ka zhvilluar metodologjitë përkatëse të të dy instrumentave të sipërpërmendura, të cilat janë pilotuar gjatë kësaj periudhe, si dhe ka paraqitur propozimet konkrete sesi këto praktika mund të integrohen në punën e Kuvendit.

Në lidhje me sa më sipër, WFD mbetet e hapur dhe e gatshme për të vijuar bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë dhe të ofrojë ekspertizë për aplikimin e dy metodologjive të Kontrollit Post-Legjislativ dhe Vlerësimit Preventiv për Korrupsion për ligje dhe projekt-ligje me rëndësi në kuadër të procesit të mirëqeverisjes dhe luftës ndaj korrupsionit.

Me respekt,



Valbona Kuko

Drejtore WFD Shqipëri

Rruga "Themistokli Gërmenji", Kati 3, Ap. 2, 1010, Tirana, Shqipëri Email: [valbona.kuko@wfd.org](mailto:valbona.kuko@wfd.org)